



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

#### 4 Mars 2013. Takim Kryetarin e Bashkisë së Elbasanit

Me datën 4 Mars 2013 pranë Bashkisë Elbasan u zhvillua një takim mes kryetarit të Bashkisë Z. Qazim Sejдини dhe një grupi përfaqësues të Ambasadës PINK / LGBT Pro Shqipëri. Pjesëmarrës në takim ishte dhe një përfaqësues nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vijim të një bashkëpunimi mes Ambasadën PINK / LGBT Pro Shqipëri dhe KMD-së.

Z. Altin Hazizaj, Ambasador i Ambasadës Pink falenderoi Z. Sejдини për mikpritjen duke thyer kështu kufijtë e kryeqytetit dhe duke i dhënë mundësi komunitetit LGBT të kësaj zone të Shqipërisë të ndihen të vlerësuar dhe të mirëpritur nga Bashkia e tyre.

Z. Qazim Sejдини nga ana e tij, për krahas falenderimeve dhe urimeve për punën kurajoze dhe të vështirë të komunitetit LGBT duke marrë parasysh rolin e Tiranës si një vend nga burojnë reforma dhe ndryshime shumë të rëndësishme për vendin, vuri në dukje edhe sfidat me mentalitetin dhe diskriminimin, sidomos në mjedise ku çështja LGBT nuk ka mundur të njihet e diskutohet më parë.

Specialistja nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Amarda Çoku, vlerësoi mbështetjen e Bashkisë së Elbasanit në luftën kundër diskriminimit duke punuar për të luftuar paragjykimet ndaj të gjitha grupeve të diskriminuara dhe marginalizuara në vend.

Të pranishmit vunë theksin që gradualisht personat LGBT, pavarësisht ku jetojnë duhet të kenë ndihmën dhe mbështetjen e institucioneve ashtu si çdo qytetar tjetër i kësaj vendi.

#### Zyra e Marrëdhënieve me Publikun



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)